



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 20 janar 2011
Nr. ref.: RK 82/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 36/09

Parashtruesi

Ruhan Berisha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të mosekzekutimit të Aktgjykimit C. nr 388/05 të
Gjykatës Komunale të Gjilanit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Ruhan Berisha nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston mosekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Gjilanit, të datës 20 tetor 2005.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së shtruar për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese është mosekzekutimi i Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale të Gjilanit, C. nr. 388/05, i datës 20 tetor 2005, me të cilin z. Berisha i është aprovuar në tërësi kërkesëpadia dhe është obliguar Konzorciumi "Iliria" nga Gjilani që atij, në cilësinë e paditësit, t'ia kthejë shumën e të hollave si në pikën II të Aktgjykimit.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 20 i Ligjit 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe neni 54 (b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese më 03 shtator 2009.
6. Më 5 shkurt 2010, Gjykata Kushtetuese ia dërgoi Agjencisë Kosovare të Privatizimit njoftimin për regjistrimin e lëndës me kërkesën për përgjigjeje në përputhje me nenin 22.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, dhe asnjëherë nuk mori përgjigjeje në këtë kërkesë.
7. Më 15 qershor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Iliriana Islami, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan, Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović, brenda të njëjtës dite i paraqiti rekomandimet e veta për të refuzuar lëndën si të palejueshme para përbërjes së plotë të Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 15 shkurt 2002, z. Ruhan Berisha, në cilësinë e bashkuesit të mjeteve, kishte lidhur kontratë për bashkimin e mjeteve për ndërtimin e objektit afaristo-banesor "ILIRI-5/1" me Konzorciumin "Iliria-5/1", të cilën e përfaqësojnë; Kombinati i Tekstilit "INTEGJ" dhe NHIN "MORAVA E BINQES", në cilësinë e bartësit të investimeve, nën kushtet e specifikuara në kontratë e me qëllim të fitimit të drejtës së pronësisë në banesën në lamelën I, hyrja e II-të, kati i parë, banesa nr. 23, në sipërfaqe prej 64,21 m² e që parashihej të jetë pjesë e objektit që duhej ndërtuar.
9. Kjo kontratë ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjilan, më 19. 02. 2002, dhe mbanë nr. VR. nr. 357/02.
10. Sipas kushteve të kontratës punët ndërtimore do të duhej të përfundonin, më së largu, deri në afatin e 18 muajve nga dita e lidhjes së kontratës.
11. Pasi që kishte paguar dy këste të pagesës sipas afateve të parapara me kontratë, z. Berisha ishte informuar se objekti nuk po ndërtohet dhe i pakënaqur me këtë gjendje, më

- 13 maj 2005, ai paraqiti padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës duke kërkuar zhdëmtimin në shumën prej 27, 611.00 €.
12. Më 9 qershor 2005, me Aktvendimin SCC-05-0148, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës lëndën ia kishte referuar Gjykatës Komunale të Gjilanit si Gjykatë kompetente për vendosje.
13. Gjykata Komunale në Gjilan, më Aktgjykimin e datës 20. 10. 2005, ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit z. Ruhan Berisha, dhe ka anuluar kontratën mbi bashkimin e mjeteve për ndërtimin e objektit afaristo – banesor "Iliria 5/1" dhe ka obliguar të paditurin, Konzorciumin Iliria, që paditësit t'i paguajë vlerën prej 27.611 € dhe kompensimin për shpenzimet e procedurës në shumën prej 151 €.
14. Më 15. 03. 2006, vendimi i Gjykatës Komunale është bërë i **formës së prerë dhe i ekzekutueshëm**.
15. Më aktvendimin E. nr. 249/06, Gjykata Komunale në Gjilan ka refuzuar kundërshtimin e debitorit Konzorciumit "Iliria", ushtruar kundër aktvendimit të kësaj Gjykate për lejimin e ekzekutimit.
16. Kombinati i tekstilit nga Gjilani, pra debitori, likuidohet më 01. 12. 2006.
17. Ruhan Berisha e plotëson formularin në AKP, mirëpo nuk merr asnjë përgjigje.
18. Pas kësaj, paditësi, z. Berisha më nuk i drejtohet Dhomës së Posaçme edhe pse vendimi i Gjykatës Komunale të Gjilanit ka të bëjë me Konzorciumin "Iliria", e ai është likuiduar në vitin 2006.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij nuk përcakton qartë se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutë i ishte shkelur, por kërkon ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Gjilanit.

Vlerësimi i lejueshmërisë të kërkesës

20. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.", dhe

nenit 48 të Ligjit i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

21. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në lëndë, Gjykata konstaton qartë se pas aktgjykimit të marrë nga Gjykata Komunale në Gjilan (Aktgjykimi C. nr. 388/05), parashtruesi i kërkesës duke e ditur faktin se debitori i tij Konzorciumi "ILIRIA", gjegjësisht përfaqësuesit tij, janë likuiduar, nuk iu ka drejtua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme e cila në bazë të Rregullores 2002/13 të UNMIK-ut ka juridiksion për

vendosje pasi z. Berisha tashmë e kishte aktgjykimin e gjykatës komunale e që nuk ishte ekzekutuar, ndërsa administrimin për Konzorciumin "LIRIA", gjegjësisht përbërësit e tij, e kishte marrë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

22. Gjykata gjithashtu, thekson me këtë rast se legjislacioni i brendshëm, e sidomos Rregullorja e sipërpërmendur për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, parasheh kompetencën për kontestet pronësore për paditësit që padisin kompanitë që janë nën administrimin e AKM, ndërsa në nenin 9.7 kjo rregullore shprehimisht përcakton se "Vendimi i marrë lidhur me një kërkesë sipas nenit 4 ose zgjidhja e ankesës konform nenit 4.3 është përfundimtar dhe i detyrueshëm për palët në fjalë, dhe duhet të ekzekutohet nga organet adekuate në pajtim me ligjin në fuqi.
23. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata vlerëson se parashtuesi do të duhej t'i ishte drejtuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme para se ti drejtohej me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.
24. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është qe t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës, do të sigurojë mjet efikas ligjor kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni v. France nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999).
25. Gjykata përcakton gjithashtu se, thjeshtë një dyshim për sa i përket perspektivës së çështjes nuk është i mjaftueshëm për të përjashtuar një ankues nga detyrimi i tij për t'u ankuar në organet kompetente vendase (shih Whiteside v the United Kingdom, vendimi i datës 7 mars 1994, kërkesa nr. 20357/92, DR 76, f. 80).
26. Parashtuesi i kërkesës gjithashtu, nuk e ka qartësuar kërkesën, nuk e ka arsyetuar atë as në aspektin procedural e as substancial në mënyrë që të dëshmonte se një e drejtë kushtetuese i është cenuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe dëshmive të ofruara, dhe pas shqyrtimit të çështjes, më 15 qershor 2010, përfundoi se parashtuesi i kërkesës NUK i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe njëzëri,

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese

Iliriana Islami

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani